

K O N T R A T E
PER THEMELIMIN E SHOQERISE "PNI-2001 SHPK"



NENI 1

Zoti Arian LAKO, person fizik shqiptar me adrese Rr. « B.Burri » Pallati i Aviacionit (i ri) Shk.17, Tirane dhe zoti Andrea MALIQARI si person fizik shqiptar me adrese Rr « M.Gjollesha », Pall.22, Sh.1, Ap.12, Tirane, te cilet kane krijuar nje shoqeri private me qender ne Tirane e quajtur "PNI-2001 " miratuar si person juridik ne Shqiperi me vendin te Gjykates se Rrethit Tirane me numur _____ date _____ kane vendosur qe firma e mesiperme te marre formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (SHPK) duke shprehur vullnetin e tyre te lire.

NENI 2

Shoqeria vepron ne perputhje me dispozitat ligjore shqiptare, per shoqerite tregtare, si dhe te dispozitave te statutit te saj qe i bashkelidhet kesaj kontrate.

NENI 3

Emri i shoqerise eshte "PNI-2001 SHPK"

NENI 4


Shoqeria ka per objekt te veprimtarise e saj:

- Projektimin ne fushen e arkitektures dhe te ndertimit : plane rregulluese fshatrash dhe qendrash te banuara, studime pjesore urbanistike, planvendosje objektesh te vecanta, projekte ndertimesh civile, industriale, turistike, bujqesore etj. deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, projekte ndertimesh civile, industriale, turistike, bujqesore etj. mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, projektimi i objekteve sportive, projektim pejsazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekoru etj.), projektim interieresh, mobiljesh, pajisjesh, dizajni industrial, projektimin e strukturave te zakonshme prej murature tulle, guri, betoni, b/a, e metalike, projektimin e strukturave te shkalles se larte te veshtiresise prej b/a (paranderje guacka, kulla, sillose etj), projektimin errugeve dhe te veprave te artit ne rruge.

- Zbatime ne fushen e arkitektures dhe ndertimit : punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj, ndertime civile dhe industriale, ndertime rugore dhe aeroporte, ndertime hekurudhore, punime speciale te shinave dhe te binareve, ndertim vepra arti rugore dhe hekurudhore, rikonstrukcion godinash civile, ekonomike, veshje fasadash etj.

- Tregtimin e mallrave brenda vendit e te eksport-importit me shumice e me pakice si ushqimore e jo ushqimore, industriale, tekstile, mallra te konsumit te gjere, prodhime lekure, prodhime plastike, kimikate e detergente, prodhime bujqesore e produkte blegtorale, paisje e pjese elektronike, paisje elektroshtepiake, prodhime farmaceutike, kozmetike, lende te para e gjysem te perpunuara, linja e makineri, pjese kembimi te ndryshme, pije alkolike e gjysem alkolike, duhan, cigare, bime medicinale, kafe dhe te gjitha mallrat e tjera qe lejohen te tregtohen.

- Hapjen e lokaleve te ndryshme, si restorante, mini e supermarket, bar bufe, ndertim hotelesh turistike e ndertesa banimi, magazine mallrash etj.



- Kryerjen e transportit te mallrave brenda dhe jashte vendit dhe hapjen e agjensive turistike.

- Duke qene si komisioner, agjent tregtar, ndermjetesues apo perfaqesues i firmave te huajja e vendase.

- Investime ne fushen e ndertimit, industrise etj.

NENI 5

Qendra dhe selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1000 USD e cila perbehet nga kontributi ne USD:

Andrea MALIQARI 500 USD

Arian LAKO 500 USD

Per zhvillim aktiviteti mund te perdoret dhe kapitali huaj.

NENI 7

Fitimet neto te realizuara do te ndahen ne perputhje me perqindjen e kontributeve te derdhura nga secili ortak, per formimin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Shoqeria ka si administrator zotin Andrea MALIQARI.

Kjo kontrate eshte hartuar ne Tirane me _____

PER SHOQERINE "PNI-2001"

Andrea MALIQARI

Arian LAKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA

Nr. 1458 rep.

Nr. 223.Kol.

VERTETIM

Sot me daten 17.05.2000 para meje noteres Eqerem Gaxholli u paraqiten personalisht palet e mesiperme: Andrea MALIQARI, lindur ne Korce e banues ne Tirane dhe Arian LAKO, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar te cilet me deklaruan se sa me siper eshte nje kontrate dhe une e vertetoj ate rregullisht.

NOTERE

Noter Notaio, Notary
EQEREM GAXHOLLI
TIRANA ALBANIA
Tel. 45588